SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË
" HEC LLENGE " SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2020

TË PËRGJITHSHME DHE POLITIKAT KONTABËL

Shoqëria "HEC LLENGE" shpk, u regjistrua si biznes në datë 25/09/2012 me administrator Z. Harallambe Gjoka, me objekt veprimtarie: Ndërtimi i hidrocentralit. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT L22125012H.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2020 janë përgatitur në përputhje me kërkesat Nr.25/2019 dt.10.05.2019"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kontabël Kombëtare SKKP Nr.2, I ndryshuar.
Referuar Nenit 4 të Ligjit 25/2019 dt.10.05.2019"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare Njesia ekonomike kategorizohet në: njësi ekonomike e Vogel, ndërsa referuar VKM. Nr. 17, datë 16.01.2019
Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKKP Nr. 2 janë:
- Parimin e paraqitjes me besnikeri;
- Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
- Parimin e pa-anëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;
- Parimin e maturise pa optimizem të tepruar, pa nën e mbivlërësim të qëllimshëm;
- Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare;
- Parimin e qëndrueshmerisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël;
- Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave;

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2020-31.12.2020.

Kontabiliteti i shoqërisë "HEC LLENGE" shpk, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe atë të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave, por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2020 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rrumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njejtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë i besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me pergjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhur edhe me përgjegjësinë e zbatimit te objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

HEC LLENGE
NIPT L22125012H
Rr Kavajes, Nr 151 Tirane

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVI
AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **916,369 lekë**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumetave, përsa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën **653.103 lekë**, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv të bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019	1.569.472	lekë
Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2020	916.369	lekë
Diferenca	653.103	lekë

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Të drejta të arkëtueshme në vlerën **188.329.736 lekë** ku përfshihen llog 411 ne euro dhe ne lek "Klientë për mallra, produkte e shërbime" 4,435,956 lekë; llog 4455 "TVSH e zbritshme" 136.285.470 lekë; llog 449 "Llogari dogane" 5.020 lekë; llog 418 "Parapagime të dhëna" 28.203.567 lekë dhe llog 4181 "Parapagime Siemens" 19.399.723 lekë.

Inventaret me vlere 69.816.355 ku perfshihet llogaria 3127 "Materiale te tjera" me vlere 8.190.437 leke, llogaria 327 "Inventar i imet" me vlere 21.667 leke dhe llogaria 332 "Punime ne proces" me vlere 61.604.251 leke

Shpenzime te shtyra ne vleren 18.395 leke ku perfshihet llogaria 486 "Shpenzime te periudhave te ardhme"

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale janë në vlerën 669.337.524 lekë te paraqitura te detajuara ne tabelen e amortizimit. bashkangjitur bilancit.

AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivet afatgjata jomateriale janë në vlerën **29,332,800 lekë,** ku përfshihet llogaria 205 "Koncesione, të drejta të ngjashme, licensa dhe të ngjashme".

AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE

Në këtë seksion përfshihet llogaria 263 "Aksione të tjera dhe letra me vlerë" me vlerë **6.984.000 lekë**.

HES LLENGE
NPT L22125012H
Rr Kavajes, Nr 151 Tirane

PASIVI
HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2020, detyrimet në total janë në vlerën **911,541,289 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë **911,541,289** lekë, ku përfshihen:

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit me vlerë 131,509,990 lekë ku përfshihet llog 401 "Furnitorë për mallra, produkte e shërbime".

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,242,382 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore".

Të pagueshme për detyrimet tatimore me vlerë 164,365 lekë ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi të ardhurat personale" me vlere 30.777 dhe llogaria 444 "Tatimi mbi fitimin" me vlere 130.588 leke.

Detyrime të tjera afatshkurtëra në vlerën 775,673,990 lekë, ku përfshihet llogaria 467 "Debitore te tjere, kreditore te tjere" 424.023 leke, llog 46701 "Energjia ekologjike" 14.143.482 lekë, llog 46702 "C&s Energy" 112.130.201 lekë, llog 46704 "KOASH" 237.983.208 lekë dhe llogaria 46703 "Eko Vepra" 136.908.400 lekë dhe llogaria 47101 "Export 2 per riparim" 8.750 leke.

KAPITALI

Gjendja e llogarive te Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën 6.984.000 lekë dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për 6.984.000 lekë, Primi i lidhur me kapitalin 41.904.000 lekë, fitimi i pashpërndarë 1,190,929 lekë dhe fitimi i vitit ushtrimor 2020, marrë nga PASH-i, me vlerë 3,114,961 lekë.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2020, Shoqëria "HEC LLENGE" shpk ka realizuar shpenzime në masën 50.789.132 lekë. Shpenzimet janë si më poshtë:

Shpenzimet të tjera shfrytëzimi me vlerë 6,172,897 lekë, ku përfshihet: llog 611 "Trajtime të përgjithshme" 391.967 lekë, llog 615 "Mirëmbajtje dhe riparime" 155.018 lekë, llogaria 616 "Sigurime" 1.350.580 leke, llogaria 621 "Personel nga jashte ndermarrjes" 222.614 leke, llogaria 625 "Transferim, udhetim, dieta" llogaria 626 "Shp postare dhe telekom" llogaria 628 ne leke dhe ne euro"Shërbime bankare" 82.168 lekë, llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore"3.615.035 leke, llogaria 638 "Tatime te tjera" 29.483 leke, llogaria 654 "Shpenzime per pritje dhe perfaqesime" 15.200 leke, llogaria 657 "Gjoba dhe demshperblime" 129.850 leke, 658 "Shpenzime te tjera" 42.216 leke.

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore/shëndetsore dhe pagat dhe shperblimet e personelit 10.292.819 lekë, ku përfshihet llog 644 " Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore"dhe 641 "Paga dhe shperblime personeli"

Humbje nga kembimet valutore me vlere 3.941.540 leke

Shpenzime amortizimi me vlere 30.381.876 leke

HEC LLENGE
NIPT L22125012H
Rr Kavajes, Nr 151 Tirane

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **54,483,918 lekë,** ku përfshihet llogaria 704 "Shitje e punimeve dhe sherbimeve" me vlerë 56.460.020 leke, lekë, llogaria 788 "Të tjera" (1.976.102) lekë dhe llogaria 769 "Fitim nga kembimet valutore" 238 leke.

PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	3.695.025
SHPENZIME TE PANJOHURA	172.066
TATIM FITIMI (15%).	580.064
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	3.114.961

PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në lëvizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim	1,569,472 lekë
Mjete monetare ne fund te periudhes	916,369 lekë
Rritja/(rënia) neto e mjeteve monetare	653,103 lekë

Pra, ka përputhje te plotë të pasqyrës të fluksit monetar dhe gjendjes të aktiveve monetare të vendosura në aktiv të bilancit.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej 6.984.000 lekë, e cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2020.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.
Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2020.

Tiranë , më 26.03.2021

Ekonomisti

Eva Cece

Administratori

Harallambe Gjoka

HEC LLENGE
NIPT L22125012H
Rr Havalès, Nr 151 Tirane